



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 27, Datë 10.02.2020

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEGA-G” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.02.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 28/4 Prot, datë 03.02.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124 Prot, datë 22.01.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.08.2001, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe mban NUIS K27713604T. Objekt i veprimtarisë së saj është: “Projektim, ndërtim dhe operim i H.E.C.-ve, ku përfshihet ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- gërma “c” (të dhëna për aplikuesin)
Do t'i kërkohet shoqërisë saktësimi i deklaratës në lidhje me ushtrimin e akiviteteve të tjera.

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- gërma “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria)
Shoqëria duhet të përcjellë Vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës për vetë shoqërinë.

Neni 9, pika 3: Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave),
Do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije mbi ecurinë e procesit të apelimit të gjobës.
- gërma “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit)
Do t'i kërkohet ti paraqesë në ERE edhe pasqyrat financiare për vitin 2018.

Neni 9, pika 4.8, Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike

- gërma “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve; E paplotësuar
- gërma “b”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. E paplotësuar
- gërma “c”. Lista e kontratave të mëparëshme të realizuara (nëse ka patur). E paplotësuar

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA -G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI